



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE ME RASTIN 25-VJETORIT TË
DEKLARATËS KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT 1990,
E MBAJTUR MË 2 KORRIK 2015**

**SVEĆANE SEDNICE POVODOM 25-GODIŠNJICE USVAJANJA
USTAVNE DEKLARACIJE OD 2. JULA 1990.,
ODRŽANE 2. JULA 2015. GODINE**

**KORRIK - JULI
2015**

Mbledhjen solemne e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës të vitit 1990,
Jemi jashtëzakonisht të nderuar sot, që pas 25 vjetësh, në këtë vit jubilar, i kemi të pranishëm në sallën tonë të Kuvendit deputetët të cilët e kanë shpallur Deklaratën Kushtetuese të Kosovës.

I falënderoj shumë nga zemra për arsye se ata para 25 vjetësh nuk e kanë pasur këtë mundësi që ta bëjnë atë akt solemn dhe trimëror nga kjo sallë, ku e kanë pasur vendin.

Mirë se keni ardhur! Faleminderit shumë!

I nderuar ish-kryetar i Kuvendit i vitit 1990, zoti Iljaz Ramajli,
Të nderuar deputetë,
E nderuara presidente e Republikës, zonja Atifete Jahjaga,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare,
Më lejoni që në mënyrë të veçantë të përshëndes njërin nga miqtë më të mirë, më të fuqishëm që ka pasur Kosova, që e kanë pasur shqiptarët, kongresmenin Eliot Engel.
Mirë se keni ardhur në Kosovë, i nderuar zoti kongresmen.

Mr. Congressman welcome in Kosovo!

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,
Të nderuara zonja dhe zotërinj të pranishëm,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e shënimit të 25-vjetorit të miratimit të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990.

Të nderuar deputetë,
Më lejoni që me një fjalë rasti të ju drejtohem nga foltorja!

Të nderuar të pranishëm,
Më lejoni edhe një herë, që në fillim, në emrin tuaj, t'i shpreh mirëseardhje në Kosovë dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës mikut të shquar të vendit tonë, të pavarësisë dhe lirisë sonë, kongresmenin Eliot Engel.

Welcome mr. Engel!

Të nderuar të pranishëm,
Jemi mbledhur sot, në këtë seancë solemne, në nderim dhe respekt të 2 Korrikut 1990.

Në këtë ditë, 25 vjet më parë, delegatët e Kuvendit të atëhershëm të Kosovës e nxorën Deklaratën Kushtetuese.

Sot, kemi nderin t'ju kemi këtu në Kuvendin e Kosovës të lirë dhe të pavarur, dhe njëkohësisht të shprehim nderim për ata delegatë që tash nuk janë në mesin tonë.

Të nderuar të pranishëm,

Zonja e zotërinj,

Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990 përbën një moment të rëndësishëm në historinë e lëvizjes sonë kombëtare të gjysmës së dytë të shekullit XX:

Kjo lëvizje kishte filluar me demonstratat e vitit 1968;

Ishte rritur në aktivitetet e organizatave patriotike ilegale të asaj kohe;

Kishte shpërthyer vrullshëm në pranverën studentore të vitit 1981, për të vazhduar me demonstratat e fuqishme të viteve '88, '89, '90;

Ishte një përballje e madhe me nacionalizmin agresiv serb;

Në epiqendër të kësaj përballje ishte trashëgimia e rendit kushtetues të vitit 1974;

Serbia kërkonte më pak se '74-ta;

Lëvizja jonë kombëtare synonte më shumë.

Shqiptarët nuk mund të mashtroheshin me masa gjysmake ekonomike dhe politike.

Duhej dhënë fund diskriminimit kombëtar që shqiptarëve u bëhej në të gjitha nivelet e sistemit jugosllav.

Barazi ose shkëputje! - ky ishte vullneti politik i asaj kohe.

Në vitin 1989, Serbia, nëpërmjet dhunës policore e ndërmori agresionin kushtetues kundër Kosovës.

Nëpërmjet këtij agresioni, Kosovës iu hoqën të drejtat kushtetuese të vitit 1974. Një vit më pas, delegatët e Kuvendit të Kosovës bënë atë që ishte vullneti politik i kohës i qytetarëve.

Nëpërmjet Deklaratës Kushtetuese e anuluan agresionin kushtetues të Serbisë të marsit 1989 dhe njëkohësisht i avancuan shumë të drejtat kushtetuese të Kosovës.

Kosova bëhej subjekt i barabartë politik me republikat tjera të ish-Jugosllavisë.

Ishte një veprim i duhur dhe në momentin e duhur.

Jugosllavia komuniste nuk kishte gjasa për të mbijetuar dhe duke e aneksuar Kosovën, Serbia synonte që në shpërbërjen e Jugosllavisë, Kosova të mos figuronte fare si çështje ndërkombëtare.

Kësisoj, Serbia synonte ta shkatërronte bazën legale të së drejtës së Kosovës për shkëputje.

Përkundër kësaj, Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut ishte avancim i kësaj baze legale.

Ishte një pikënisje e duhur për platformën e ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Kjo do të thoshte se Kosova nuk mund të trajtohej si çështje e brendshme e Serbisë.

Ëndrra jugosllave kishte marrë fund njëherë e përgjithmonë.

Fitorja jonë e parë e madhe është pikërisht fitorja në luftën për ndërkombëtarizimin e çështjes sonë.

Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut dhe lëvizja civile e viteve të '90-ta i kanë meritat e mëdha në këtë fitore.

Ato ishin një ndihmesë e madhe kur erdhi momenti i madh, dita e madhe e fillimit të kryengritjes së armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kur ne rrokëm armët, tanimë bota e kishte të qartë se këtë po e bënim për një kauzë të madhe, për kauzën e lirisë.

Kjo na e solli edhe përkrahjen politike dhe ushtarake të botës demokratike.

Të nderuar të pranishëm,

Më 1999, ne nuk e fituam vetëm lirinë, por e fituam edhe rreshtimin në anën e drejtë të historisë, në anën e demokracive perëndimore.

Falë këtij rreshtimi, ne ecëm më tutje:

E bëmë Kosovën shtet të pavarur dhe tani po e konsolidojmë këtë shtet për ta bërë të gatshëm për integrimet euroatlantike.

Prandaj, për ne ky rreshtim është dhe do të mbetet vlerë e pacenueshme kombëtare.

Ne besojmë në këtë vlerë.

Ne besojmë në partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me botën perëndimore, si e vetmja rrugë për t'i zgjidhur problemet dhe për t'i tejkaluar sfidat e shtetndërtimit dhe të integritetit.

Ne do të kemi sukses!

Faleminderit! Urime!

(Duartrokitje)

KRYESUESI SABRI HAMITI: E ftoj kongresmenin zotin Eliot Engel për një fjalë rasti.

(Duartrokitje)

KONGRESMENI ELIOT ENGEL: Thank you very much and thank you Mr. Speaker for those very important words and hello to all my friends of Kosova.

It's wonderful to be here, this is the third time that I've had the honour to address the Assembly and believe me it is really a great honour for me.

When I come to Kosovo I feel like I am coming home, the people of Kosova have greeted me with such warm welcome and good feeling and wonderful friendship, and wherever I go here people are as nice as can be, they want to take my picture and they want to say hello, and it is just a tremendous great honour for me.

You know my friends I've sort of grown up in my political life with Kosova, I was first elected to the United States Congress back in 1988 and I took office the following year in 1989, and that same year my good friend Hajri Bajraktari, who was born here and has lived in New York for many years, came to my office to tell me about what was going on in Kosova.

I had met Hajri before, but that meeting changed my life and I hope perhaps changed some of the lives here as well, because the more I heard about the injustice that was going on in those days in Kosova, the more I wanted to be a part of the fight, the more I wanted to be part of helping bring freedom and democracy to this wonderful land.

And you know for many years I walked around in Washington, New York in Congress and talked about freedom and the independent nation of Kosova, and I said to everyone, who would listen, for many many years we are going to have a free and independent Kosova, and here we are in a free and independent Kosovo with all of you who look so wonderful to me, I just want to let you know what it does to me, to my heart and my head and everything about me to come here and face all of you wonderful people, who are part and parcel of this great country and what makes this great country work, it is just a pleasure and an honour to see you all and to be speaking before you.

You know there were many people who doubted it, people who said no it can never be a free nation, you know in the 1990s, one of those years, I forgot the exact year, we tried to hold an election here in Kosovo, where I came and I had a little jacket that said: "Republic of Kosova – election inspector", and I was stopped at the border, they wouldn't give me a visa, they wouldn't let me come in, Milosevic said I was a trouble maker and they wouldn't let me come in, and I held a press conference at the border of Macedonia and Kosova, and there was a lot of press there, and I remember it very well because I had lost my eye glasses and I was blind as a bat, mm but I was able to say what was in my heart, and I said well I am trying to get into Kosova today, and Milosevic won't let me in, but I have news for him, one day we are all going to be in a free and independent Kosova, and we are not going to let him in, and I said that and I joked about it in a way, but it really was no joke, because I knew, as all did all of you, that a free and independent Kosova would be a reality one day, and as you all know Kosova has no better friend than the United States of America, and the United States of America will always stand with Kosova.

Now as you know tonight we have a party at the Embassy, the US Embassy, celebrating July the 4th, which is the American Independence Day, and then in two days we have an open house, my good friend Hajri Bajraktari, so I am celebrating it twice this year, and we celebrate the independence of the United States of America, and we call ourselves the oldest democracy in the world, I think Kosova is probably the youngest democracy in the

world, and just the way our forefathers in America in the 1700s sat together and broke away in those days from England, because we wanted freedom for our people, and we wanted independence for our people, that's what the brave people of Kosova did twenty five years ago, because you wanted the same types of freedoms that we have in America that few other countries have as well, and I wanted to repeat that the United States of America will always stand with the brave people of Kosova.

Twenty years ago, when I first came to Kosova, actually twenty two years ago, and I participated in a ribbon cutting here in Prishtina, at the USIA Office, and I remember the Serbian officials were in charge and were two men very kind of a dower looking, kind of looked at me and when I came to cut the ribbon I said as far as I was concerned I wasn't cutting the ribbon for the United States Information office, I was cutting the ribbon for the United States Embassy, because one day, in a not too distant future I said, Kosova would be a free and independent nation, and this would be the first of ribbon cuttings for American Embassies, and just yesterday I visited the new site here, just outside of Prishtina, where the new US Embassy is going to be built, it's a huge, large embassy, and what it shows is that America's commitment for Kosova is here to stay, we are building the biggest embassy, and we are doing it because we believe in the people of Kosova, we believe in a democracy of Kosova, we believe in the fact that the people here want the same kinds of freedoms that cause our nation in America to break away and form it's freedom and independence.

So when autonomy was removed for Kosova and when the freedoms were removed for Kosova, people just didn't sit back and take it lightly, people got up and fought, people got up and said no, we want to be a free and independent nation. Now, with all nations with all new nations, even with the nations that are old, there are always growing pains, there are always things to do when I sit in the United States Congress and we have votes, and we just had a big battle on trade, and there's all kinds of other things, it really isn't easy, because we're always striving, even in America, to perfect our democracy, and sometimes we get frustrated and we say well does this really work, has it changed, is it impossible, but democracy in my opinion is never impossible, it involves the good will of all the people participating in it, and so regardless of what your political party is, regardless of what you believe, as far as I am concern, you are all patriots, you are all here participating in democracy and doing things that many countries in the world don't get a chance to do, democracy is unfortunately a non majority in the world, there are minority in the world, and countries that participate in a democracy, I think do the finest kinds of things.

There are many issues and many things that need to be done; yesterday I met with the judges, rule of law, of course is so important, fighting corruption is important, there are things that need to be happening here with economy, that's important, you all know better than I do, but again I want to tell you we will always be with you, I certainly will always support you, and as I walked the streets of Kosova and see my friends, ordinary people in the street, who want to take a picture with me, who want a just touch me, because I represent the United States of America, I want to tell you, it's from the bottom of my heart I love the people of Kosova, each and every one of you, I love what you have done,

and I am absolutely committed to continuing as long as I am in office, to continue to help in any way I can.

Now, I have been around past few days and lot of the media has asked me questions about the controversy involving the special court, and feel I have to mention that to you, because I feel I have to let you know how I feel. There are lot of tough choices that have to be made, and the people of Kosova have been making them, throughout the declaration of Independence, and I know that the independence day by the way is February 17th, because my birthday is the very next day the February 18th, and I always say the best birthday present I ever got was the Independence of Kosova.

Mmm... the way I look at the situation, and I know it's a very hard decision, is it's not a situation of will there be a special court or nothing, to me the question is will there be a special court or will there be a United Nation's court, cause I believe that if there's not a special court, the United Nations will have a court, and I don't believe that Kosova will particularly get a very good break in the United Nations, I think that there are lots of problem with the United Nations, and I think it is a stack deck against Kosova, first of all Kosova should be a member of the United Nations, it's been blocked as you know from being a member of United Nations, because of Serbia and Russia, and that is wrong, that is unfair, every time in Washington when we talk about US funding for the United Nations, or talk about the United Nations in general, I raise the fact that Kosova should be a member of the United Nations, every foreign dignitary that comes into my office, who represents a country that has not yet recognised Kosova, I speak with them, and ask them why not??!!, and tell them that they should recognise Kosova, I do that with Prime-Ministers, I do with Presidents, I do it with Foreign Ministers, and I certainly do with ambassadors, practically each and every day in Washington. So I don't believe the United Nations is particularly fair when it comes to Kosova, and I do believe that will be the alternative to a special court, if the special court is not approved, I think there will be UN court, and I think that will be a big problem in my opinion for Kosova, because I don't again think the United Nations is a fair venue.

So as a friend of Kosova, I think I have the obligation to tell you how I feel about this another important issue. I believe, ultimately, Kosova must be and will be a member of the European Union and down the line Kosova must be and will be a member of NATO, that's my goal, that's what I want to work for, that's what I want to see. There is no reason to keep Kosova out of the EU, there is no reason not to have visa liberalization that has to happen, there is no reason for Kosova to be blocked from the melanin in challenges and the moneys that come with that, and I have been working on that issue in Washington, and each and every issue, I will pledge to you that I will continue to work to help the people of Kosova, and finally let me say this, whatever political party you belong to here, I want you to know that I respect you, I don't take positions on elections in any of the countries but my own, all I want to see is a democracy, a rule of law, end of corruption, all the things you all want to see, and want to continue to fight.

And I want to say to each and every one of you, you always have an open door to me, you always, if you call me, if you want to see me, I am always happy to see you, I am

always happy to learn from you, I am always happy to hear your opinions, your opinions are very important, I respect all of you, I respect Kosova, and I feel like it's my second home.

So I want to thank you for giving me the great honour of being here, of addressing you, and again I want to repeat that the people of America and the people of Kosova will always be one, we are friends, we are partners, and that's the way will always continue to be, and as long as I am in the Congress you know that I will continue to fight for the wonderful people of Kosova, thank you so much, and thank you for the honour of letting me address you.

KRYETARI: Thank you Mr. Congressman Engel for these kindly words, thank you for everything that you have done for our country.

Të nderuar deputetë,

Tani nëpërmjet monitorëve ne do ta kemi rastin t'i ndjekim disa nga momentet më emocionuese të 25 vjetëve më parë, momentin e aprovimit të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut. Shumicën e kolegëve deputetë i kemi këtu. Faleminderit!

Ju lutem, ta ndjekim këtë moment!

Fragment nga dokumentari

Gazetari: Zonja Bredli, siç e shihni dyert janë të mbyllura. Delegatët presin jashtë. Si e komentoni këtë?

Zonja Bredli: Mendoj se duhet të mbajmë mbledhje.

Gazetari: Por, ata nuk po i hapin dyert.

Zonja Bredli: Kjo nuk është me rëndësi. Para se të fillonte Revolucioni Francez, mbledhja u mbajt në një fushë tenisi. Në asnjë Kushtetutë nuk thuhet se Kuvendi duhet të mbajë mbledhje në një ndërtesë të posaçme.

Duhet të verifikohet kuorumi nga delegatët dhe të zgjidhet kryesuesi i mbledhjes. Dhe, kjo është e tëra çfarë e kërkon mbajtjen e një kuvendi.

Gazetari: Thank you!

* * *

Pas këtyre fjalëve, policia serbe menjëherë e morën zonjën Bredli dhe bashkë me Luljeta Pulën e përçollën në polici, e pastaj edhe e dëbuan nga Kosova.

* * *

Odmah!... Fol... Molim vas prekidajte!...

** * **

Në të gjitha hyrje-daljet në Prishtinë ishin vendosur postblloqet e policisë. Kuvendi dhe delegatët gjithashtu ishin të rrethuar nga policia. Midis turmave të njerëzve shëtisnin policë të veshur me rroba civile, ndërsa mbi kulmin e postës ishin vendosur snajperët e policisë.

Delegatët, të vendosur, e filluan mbledhjen.

BUJAR GJURGJEALI: Delegatët më propozuan që ta kryesoj këtë mbledhje, ata më autorizuan.

1. Shqyrtimi i projekt-amendamenteve prej 49 deri më 72 për Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, si pikë e parë.

Si e dytë:

2. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për hyrje në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë me nxjerrjen e Kushtetutës së re.

Dhe do jetë pika e tretë:

3. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë së Republikës Socialiste për nxjerrjen e Kushtetutës së re të Republikës Socialiste të Serbisë për të dhënë mendimin.

Dhe, si pikë e katërt:

4. Iniciativat

Meqenëse, jemi duke punuar në kushte jonormale, propozoj që të kalojmë menjëherë në pikën e parë të rendit të ditës, të mos e lexoj përsëri, rreth amendamenteve të KEF-it. Kemi marrë edhe mendimin e Komisionit Kushtetutar të Krahinës dhe propozoj, a pajtoheni me vërejtjet të cilat janë dhënë?

A jeni për atë mendim të Komisionit?

ZËRA: Po! ((Duartrokitje))

BUJAR GJURGJEALO: Kush është për? Kundër?

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, rreth shqyrtimit të propozimit të Kryesisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për hyrje në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë me nxjerrjen e Kushtetutës së re.

Edhe për këtë çështje e kemi mendimin e Komisionit Kushtetutar të Kuvendit Krahinor. Prandaj, meqenëse punojmë në kushte jonormale, sigurisht se do të kishte pasur shumë diskutime rreth kësaj, prandaj propozoj që ta aprovojme atë me mendimin e Komisionit Kushtetutar të Kosovës.

A pajtoheni me këtë? Kush është që ta aprovojme mendimin e Komisionit Kushtetutar? Arsyeja është, faktikisht e precizuar. A është dikush kundër? Abstenon dikush? Jo! Faleminderit!

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë së Republikës Socialiste të Serbisë, për nxjerrjen e Kushtetutës së re të Republikës Socialiste të Serbisë për dhënien e mendimit.

Edhe për këtë pikë, meqenëse jemi në kushte jonormale, sigurisht se do të kishte pasur shumë diskutime, prandaj propozoj që të shkojmë me mendimin e Komisionit Kushtetutar të Kosovës.

A pajtoheni me atë mendim? Kush është për atë? (Duartrokitje) Aty refuzohet, e shkruan, propozimin e Komisionit Kushtetutar. Ju lutem!

ADEM MIKULLOVCI: Delegatë, duhet të konstatohet me nënshkrimet që kanë bërë delegatët, a ekziston kuorumi i plotë për këtë mbledhje, apo jo?

BUJAR GJURGJEALO: Të pranishëm, në bazë të listës këtu të nënshkruar, prej 114 delegatë me nënshkrime dhe prej të gjitha dhomave.

Propozoj që të aprovohet! Kush është për aprovimin e kësaj iniciative për nxjerrjen e Kushtetutës së re? A është dikush kundër?

Njëzëri: Jo!

BUJAR GJURGJEALO: Abstenon dikush?

Njëzëri: Jo!

BUJAR GJURGJEALO: Ju faleminderit!

Konstatohet se u aprovua iniciativa për nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës.

(Duartrokitje)

Prandaj, më lejoni që të propozoj, e kemi edhe një deklaratë që do ta lexojë shoku Muharrem Shabani.

MUHARREM SHABANI: Duke u nisur nga vullneti i shprehur vendosmërisht anëmbanë Kosovës nga shumica e popullsisë së Kosovës, vullnet ky i sublimuar edhe në Deklaratën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për pozitë të re kushtetuese të Kosovës, si dhe duke u nisur nga roli dhe pozita e Kuvendit të Kosovës si organ përfaqësues dhe kushtetutdhënës më i lartë i pushtetit dhe i vetëqeverisjes në Kosovë, Kuvendi i Kosovës solemnisht shpall këtë:

DEKLARATË KUSHTETUESE

PËR KOSOVËN SI NJËSI TË PAVARUR DHE TË BARABARTË NË KUADËR TË FEDERATËS - KONFEDERATËS SË JUGOSLLAVISË SI SUBJEKT I BARABARTË ME NJËSITË TJERA NË FEDERATË - KONFEDERATË

1. Me këtë deklaratë shprehet dhe shpallet qëndrimi burimor kushtetues i popullsisë së Kosovës dhe i këtij Kuvendi si akt i vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë.

2. Ky Kuvend, duke e shpallur nga ana e tij dhe në nivel të tij Kosovën si njësi të barabartë në Jugosllavi, në bazë të principeve të demokracisë autentike për respektimin e vullnetit të njerëzve dhe të kolektiviteve njerëzore e kombëtare pret konfirmimin e këtij akti konstitutiv të tij në Kushtetutën e Jugosllavisë me mbështetje të plotë të opinionit demokratik në Jugosllavi dhe të opinionit ndërkombëtar.

3. Ky Kuvend, Kosovën dhe pozitën e re kushtetuese të saj e konfirmon si bashkësi politiko-kushtetuese të përbashkët të qytetarëve të nacionaliteteve të barabarta të Kosovës, ku shqiptarët si shumicë e popullsisë së Kosovës dhe një ndër popujt më numerik në Jugosllavi, si dhe serbët e të tjerët në Kosovë, konsiderohen popull – komb, e jo kombësi apo pakicë kombëtare.

4. Në ndërkohë, deri në aplikimin definitiv juridik të kësaj deklarate kushtetuese, Kuvendi dhe organet e pushtetit të Kosovës, marrëdhëniet e tyre në rendin kushtetues të Jugosllavisë i mbështetin në Kushtetutën në fuqi të Jugosllavi, e jo në amendamentet e Kushtetutës së Serbisë të vitit 1989, me ç'rast bëhet edhe anulimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës, i datës 23 mars të vitit 1989 mbi dhënien e pëlqimit në këto amendamente.

(Duartrokitje)

5. Kuvendi i Kosovës, deri në nxjerrjen e Kushtetutës së re të Kosovës, tash e tutje do të komunikojë publikisht me këtë emërtim, duke e emërtuar njëkohësisht bashkësinë shoqërore-politike, organ i së cilës është vetëm si Kosovë.

Prishtinë, 2 korrik 1990

Delegatët nënshkrues të Deklaratës, 114 delegatë të Kuvendit të Krahinës Socialiste të Kosovës.

BUJAR GJURGJEALO: Meqenëse është nënshkrimi i 114 delegatëve, faktikisht ta bëjmë në mënyrë formale dhe kush është për këtë? Pajtohemi! (njëzëri). Ju faleminderit!

* * *

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Këto janë momente të delegatëve trima të Kuvendit të Kosovës 25 vjet më parë, të cilët e bënë një kthesë historike në vendin tonë dhe ne i falënderojmë shumë. Në të njëjtën kohë, e kemi nderin që shumicën prej tyre sot i kemi këtu, për aq më tepër njërin nga ata, ish-kryetarin e Kuvendit të viteve të '90-ta, zotin Iljaz Ramajli, e ftoj për një fjalë rasti. Faleminderit!

(Duartrokitje)

ILJAZ RAMAJLI: E nderuara presidente Jahjaga,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Shumë i nderuar kongresmen Engel,

Përfaqësues të korit diplomatik, të akredituar në Republikën e Kosovës,

Unë, në fakt, nuk do ta them ndonjë fjalë të madhe pas fjalimit të kryetarit të Kuvendit, zotit Veseli, por ndiej nevojë që shkurt të ju drejtohem në emër të kolegëve të mi.

Më lejoni që në emër të delegatëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përbërja e vitit 1990, të ju falënderoj që keni vendosur që nëpërmjet kësaj mbledhjeje të veçantë të shënoni 25-vjetorin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990 dhe që na keni nderuar, duke na ftuar të marrim pjesë dhe së bashku me ju ta rikujtojmë këtë datë të rëndësishme të historisë së re të Kosovës.

Para 25 vjetësh, mu në kohën kur po e mbajmë këtë mbledhje, kjo sallë ishte e zbrazët, edhe pse atë ditë në të duhej të ishin delegatët dhe ta mbanin një mbledhje, e cila ishte caktuar rregullisht.

Salla ishte e zbrazët, por të gjithë delegatët me kohë ishin ardhur për mbledhje para dyerve të Kuvendit, të cilat ishin mbyllur me urdhër të kryetarit të atëhershëm të Kuvendit dhe të gjitha hapësirat e Kuvendit dhe të organeve tjera qeveritare, të cilat gjendeshin në këtë ndërtesë, ishin vendosur nën kontroll të plotë të njësive të policisë serbe, e cila vepronte në kuadër të policisë federale, të instaluar në Kosovë atyre ditëve.

Ndodhi ajo që besoj asnjëherë nuk kishte ndodhur dhe nuk ishte parë në historinë e parlamentarizmit të shteteve evropiane. Përfaqësuesve të zgjedhur të popullit nuk iu lejua që të hyjnë në tempullin e tyre, në mënyrë që ta kryejnë detyrën dhe obligimin e tyre, që vullnetin e shprehur unanimisht nëpërmjet tubimeve të panumërta të qytetarëve të Kosovës, të formësuar nëpërmjet Deklaratës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të datës 14 qershor 1990, dhe Deklaratës së Forumit të partive politike, rishtas

të krijuara në Kosovë, të datës 1 korrik 1990, t'ia japin formën e një akti kushtetues juridik, me të cilin do të përcaktohej dhe shpallej e drejta e Kosovës për vetëvendosje, për mëvetësi dhe për pavarësi.

Përkundër mbylljes së dyerve të Kuvendit, delegatët, siç që e dini tanimë dhe siç e pamë, duke qenë të vendosur për ta çuar në vend vullnetin politik të popullit të Kosovës, para dyerve të ndërtesës së Kuvendit, nën qiellin e hapur, e mbajtën mbledhjen e 2 Korrikut dhe e shpallën Deklaratën kushtetuese, të cilën sapo e dëgjuam, të lexuar nga Muharrem Shabani.

Deklarata Kushtetuese është hapi i parë drejt pavarësisë së Kosovës, pavarësi kjo që u ndërtua me lëvizjen paqësore për çlirim, si dhe kulmoi me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për t'u realizuar e plotë më 17 shkurt 2008, kur deputetët e Kuvendit të Kosovës e shpallën Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, i cili tashmë është njohur nga mbi 100 shtete, ndër to fuqitë më të mëdha ekonomike dhe ushtarake të botës.

I nderuar kryetar,

Sot këtu nuk janë të pranishëm të gjithë delegatët që morën pjesë në punimet e Kuvendit të Kosovës më 2 korrik, më 7 shtator dhe në disa mbledhje të mëvonshme.

Shfrytëzoj rastin t'i përkujtoj 28 delegatë, të cilët tanimë nuk janë ndër ne të gjallë, dhe shpreh nderimet dhe respektin më të thellë për ta dhe për familjet e tyre.

Duke i vlerësuar fjalët e mira dhe vlerësimet që i dhatë për aktin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut dhe për delegatët e asaj përbërjeje, më lejoni që edhe një herë të ju falënderoj ju dhe deputetët e nderuar që mundësuat shënimin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990 në këtë mënyrë dhe në këtë vend. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Iljaz Ramajli!

Të nderuar të pranishëm,

Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe me këtë e përmbyll këtë seancë solemne.

Faleminderit dhe urime të gjithëve!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*